



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/99

Datë: 17.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 98 Qeverisë së Republikës së Kosovës
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/99
Datë: 17.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6.2, 6.3 12.2 dhe 72.2 të Ligjit mbi Partneritetet Publiko Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për Dhënien e Tyre, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Komitetit Drejtues Ndërmator për Partneritetet Publiko Private (KDN-PPP) caktohet që të përfaqësojë Republikën e Kosovës si Autoritet Kontraktues në prokurimin Nr. PPP - 09 - 001 - 611 për një Partneritet Publiko Privat për të zgjeruar dhe për të operuar me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.
2. Komiteti Drejtues Ndërmator për Partneritetet Publiko Private do të ndërmerr të gjitha veprimet që lidhen me zbatimin e projektit deri në dhënien dhe regjistrimin e kontratës së Partneritetit Publiko Privat në përputhje me ligjin.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/99
Datë: 17.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet, me vërejtje, Projektligji për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit që në tekstin e Projektligjit t'i inkorporojë vërejtjet e miratuara nga Qeveria.
3. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi, pas inkorporimit të vërejtjeve, t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/99
Datë: 17.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/99
Datë: 17.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 32 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Nr. 02/L-37 dhe Udhëzimit Administrativ, Përbërja dhe Kompetencat e Komisionit të Gjuhëve, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Anulohet vendimi i Qeverisë Nr. 03/60, të datës 08.04.2009.
2. Anëtarët e komisionit të gjuhëve emërohen në këtë përbërje:
 - 2.1 Fehmi Stublla - Zyra Kryeministrit (kryetar);
 - 2.2 Nebojsha Bojkoviqi - Ministria e Kthimit dhe e Komuniteteve (zëvendëskryetar);
 - 2.3 Fadil Bytyçi - Kuvendi i Kosovës;
 - 2.4 Bedri Bahtiri - Ministria e Drejtësisë;
 - 2.5 Selami Osmani - Ministria e Administratës Publike;
 - 2.6 Nazan Safçi - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 2.7 Flutura Hoxha - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjithë sekretarët e përhershëm të ministrave përkatëse, të përfaqësuara në këtë komision.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/99
Datë: 17.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë Nr. 02/83, i datës 25.09.2009.
2. Pika 2. e vendimit Nr. 02/83, të datës 25.09.2009, zëvendësohet në tërësi si në vijim:
"Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës 2010 -2025, t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/99

Datë: 17.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7.2.2 dhe nenit 12.2.12 të Ligjit mbi Partneritet Publiko Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për Dhënien e Tyre Nr. 03/L - 090, Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L - 087, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me vendimin e Komitetit Drejtues të Projektit dhe me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Duke u mbështetur në rekomandimin e Komitetit Drejtues të Projektit të Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti, me përkrahje të komunitetit ndërkombëtare të donatorëve, rikonfigurohet transaksioni për termocentralin "Kosova e Re" ("TCKR") dhe Fusha e Linjtit në Sibovc. Transaksioni i ri do të ketë këta komponentë:
 - 1.1 Ndërtimi i centralit të ri për gjenerimin e energjisë elektrike, "termocentrali Kosova e Re" ("TCKR") me kapacitet të instaluar fillestar prej 500 (pesëqind) megavat me mundësi të zgjerimit deri në 1.000 (njëmijë) megavat dhe stabilimenteve përkatëse (të limituara) të interkoneksionit;
 - 1.2 Zhvillimi i menjëhershëm i Fushës së Linjtit në Sibovc për të ofruar linjit për centralet ekzistuese në Kosovë për gjenerimin e energjisë elektrike me djegie të linjtit (termocentrali Kosova A dhe termocentrali Kosova B) dhe njësitë e reja të termocentralit "Kosova e Re" (TCKR), kur ato të hyjnë në shërbim; dhe
 - 1.3 Participimi i sektorit privat në termocentralin Kosova B.

2. Ky transaksion i rikonfiguruar duhet të shpallet me publikimin e njoftimit në gazetatat ndërkombëtare me reputacion, i cili njoftim do të udhëzon palët e interesuara tek Memorandumi i Para-Kualifikimit i cili përshkruan hollësitë e transaksionit, kriteret minimale për përzgjedhjen, konkurrencën dhe synimet e Qeverisë për këtë transaksion. Qeveria e Kosovës ka rishikuar këto dokumente dhe aprovon publikimin e tyre.
3. Është përgjegjësi e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, që në emër të Komitetit Drejtues të Projektit PATEL dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës që të zbatojë këtë vendim dhe të promovojë procesin e suksesshëm të transaksionit gjatë muajve në vijim, duke filluar me Konferencën e Investitorëve e cila do të mbahet me/ose rreth 20 janar 2010.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/99

Datë: 17.12.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 10.000 (dhjetëmijë) euro për mbulimin e shpenzimeve shtesë për shërbyesit civilë, të cilët kanë filluar punën në objektin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, nën drejtimin e EULEX-it.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë